

# Nënshkrimi elektronik i kontratave komerciale dhe vlefshmëria e tyre

## Hyrje

Koha e pandemisë nëpër të cilën po kalojmë dhe pengesat në kontakt fizik në mes të palëve e ka ngritur në një nivel më të lartë nevojën për komunikim në distancë. Komunikimi në distancë, duke përfshirë këtu shkëmbimin e dokumenteve me postë elektronike ose nënshkrimin e tyre, nuk është më vetëm një mjet praktik i afarizmit por, një domosdoshmëri.

Praktika e deritashme e nënshkrimit të kontratave, por edhe e dokumenteve të tjera dypalëshe, ka qenë e tillë që ato janë nënshkruar në prezencën fizike të dy palëve, me vendosjen e nënshkrimit në ekzemplarë të shtypur të kontratës. Keni parasysh këtu p.sh. nënshkrimin e kontratës për kredi në bankë, ku klienti ftohet që të paraqitet fizikisht për të nënshkruar kontratën, e cila paraprakisht është nënshkruar nga zyrtarët e bankës ose të cilët e nënshkruajnë *a posteriori*.

Situatë pak më ndryshe është kur palët janë në distanca të largëta ose shtete të ndryshme. Në këto raste, praktika e do që palët pasi të kenë negociuar kontratën dhe të jenë pajtuar për kushtet dhe detyrimet e ndërsjella, do të shtypin kontratën në dy ose më shumë ekzemplarë. Pastaj, do t'i nënshkruajnë ekzemplarët dhe do t'i dërgojnë me postë palës tjetër për nënshkrim. Njësoj, pala tjetër do t'i nënshkruaj ekzemplarët e pranuar dhe do t'i kthej përsëri me postë kontraktuesit tjetër duke mbajtur ekzemplarë të mjaftueshëm për vete. Në disa raste palët do të shkëmbejnë edhe kopjet e skanuara të kontratës nëpërmes postës elektronike por, sidoqoftë i gjithë ky "proces" i nënshkrimit të kontratave është jo i përshtatshëm për afarizëm dhe e vonon fillimin e ekzekutimit të kontratës deri sa secila palë të ketë pranuar ekzemplarë fizik të nënshkruar nga pala tjetër. Shpeshherë kontraktuesit janë të pasigurt si të veprojnë gjatë periudhës derisa "procesi" i nënshkrimit të kontratave të ketë përfunduar. Nëse mund të fillojnë me ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat.

Atëherë, shtrohet pyetja **nëse nënshkrimi i kontratave duhet domosdo të jetë në formë fizike** dhe si e rregullon legjislacioni i Republikës së Kosovës çështjen e nënshkrimit elektronik të kontratave?

Përgjigja e shkurtër do të ishte: **JO**, kontratat nuk është e domosdoshme të jenë të nënshkruara në mënyrë fizike nga kontraktuesit, me disa përjashtime për rastet specifike.

## I. Nënshkrimi elektronik i kontratave komerciale

Do të nisemi nga premisa se kontratat komerciale, ligjërisht duhet të jenë në **formë të shkruar** (kontratë fizike "hardcopy" ose elektronike). Pra, e rëndësishme është që të përpilohet një kontratë, dokument i shkruar.

Ligji parasheh se "*Kur për lidhjen e kontratës nevojitet përpilimi i dokumentit, kontrata është e lidhur kur dokumentin ta nënshkruajnë të gjithë personat që detyrohen prej saj*", parasheh paragrafi 1 i nenit 57 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin më tutje: "LMD").

Kontratat nënshkruhen me qëllim për të vërtetuar ose treguar vullnetin e palëve kontraktuese, se pajtohen me atë që është shkruar në kontratë. Vullneti i palëve kontraktuese për të lidhur kontratën shprehet në formë të nënshkrimit dhe ky nënshkrim mund të paraqitet në letër ose forma tjera identifikuese. *“Vullneti për ta lidhur kontratën mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij”*, parasheh neni 18 i LMD.

Pra, kontrata komerciale mund të nënshkruhet edhe nëpërmes postë elektronike, në të cilën kontraktuesi do të shkruan p.sh. se *pajtohet me kushtet dhe detyrimet e kontratës*. Ky deklaram është i barasvlershëm me nënshkrimin e kontratës meqenëse, u tha se vullneti për ta lidhur kontratën mund të shprehet me **fjalë**, me **shenja të rëndomta** ose me **ndonjë sjellje tjetër** nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e vullnetit të palëve.

Shembull i rëndomtë është kur ne instalojmë një software (me ose pa pagesë) në kompjuterë. Me këtë rast para instalimit kalojmë nëpër disa pyetësor ku na kërkohet nëse pajtohem me kushtet e kontratës. Për të vazhduar instalimin zakonisht duhet të klikojmë buton të tipit “pajtohem”. Qëllimi i këtij veprimi është për të shprehur vullnetin tonë se pajtohem me kushtet e kontratës dhe nënshkruajmë atë. Ligjërishit me këtë rast është lidhur një kontratë për instalimin ose blerjen e “software”-it.

Pra, për lidhjen e Kontratës nuk është e domosdoshme që ajo të nënshkruhet fizikisht pasi që edhe kontrata e pa nënshkruar është e vlefshme. *“Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”*, parasheh neni 16 i LMD ndërsa, *“Kontraktuesi që nuk di të shkruajë do të vejë në dokument shenjën e gishtit...”* parasheh, paragrafi 2 i nenit 57 të LMD.

Në këtë drejtim, për nënshkrimin e kontratave komerciale është e rëndësishme shprehja e vullnetit të kontraktuesit edhe nëse e njëjta i dërgohet nëpërmes postë elektronike kontraktuesit tjetër, në të cilën është e bashkangjitur kontrata elektronike dhe shkruan p.sh. pajtohem me kushtet dhe detyrimet e kontratës së bashkangjitur dhe e konsideroj të nënshkruar. Ligjërishit kjo është sjellje nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e vullnetit të kontraktuesit për të lidhur kontratën. Kur kontraktuesi tjetër përgjigjet njëloj atëherë dokumenti do të konsiderohet i nënshkruar nga të dy palët dhe kontrata komerciale e lidhur.

*“Për lidhjen e kontratës dypalëshe mjafton që të dy palët ta nënshkruajnë një dokument ose që secila prej palëve të nënshkruajë kopjen e dokumentit të destinuar palës tjetër”*, parasheh paragrafi 2 i nenit 57 të LMD dhe vazhdon *“Kërkesa e formës me shkrim është e përmbushur, në qoftë se palët këmbejnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që bënë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi, i cili e ka dhënë deklaratën”*.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve e ka paraparë edhe shprehjen e vullnetit nëpërmes mjeteve elektronike, *“...forma me shkrim zëvendësohet edhe me deklarata me mjete elektronike, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të veçantë”*, parasheh paragrafi 5 i nenit 57. Pra, sipas këtij neni, kontratat komerciale do të konsiderohen të lidhura edhe në situatat kur kontraktuesit vendosin nënshkrimin në formë elektronike ose të skanuar në kontratën dhe ia dërgojnë me postë elektronike njëri-tjetrit.

Përfundimisht, mund të themi se kontratat komerciale mund të nënshkruhen në formë elektronike dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës e njeh si të ligjshme këtë mënyrë të shprehjes së vullnetit të palëve. Megjithatë, nuk mund të thuhet se nënshkrimi elektronik është i vlefshëm për të gjitha llojet e kontratave. **Kontratat me konsumator të lidhura në distancë** duhet t’i plotësojnë disa kërkesa ligjore shtesë të

parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit (II) ndërsa, **kontratat që kanë për objekt transaksionet e pronës së paluajtshme** nuk janë fare të vlefshme nëse nuk nënshkruhen pranë noterëve (III)

## II. Kontratat në distancë me konsumator

Kontrata në distancë është kontrata e arritur mes tregtarit dhe konsumatorit përmes një skeme ofrimi shërbimesh apo shitje të organizuar në distancë pa prezencën e njëkohësishme fizike të tregtarit dhe konsumatorit, ekskluzivisht duke përdorur një ose me shumë mjeteve të komunikimit në distancë përgjatë dhe duke llogaritur kohën në të cilën kontrata është lidhur, parasheh Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (në tekstin në vijim: “LMK”).

Me rastin e lidhjes së kontratave me konsumator, duhet pasur parasysh se ekzistojnë disa kërkesa formale shtesë të cilave palët duhet përmbajtur.

Kontratat e lidhura me konsumator nënkuptojnë kontratat të cilat rregullojnë *“marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve nga njëra anë dhe prodhuesve, furnizuesve, shitësve apo ofruesve të produkteve apo shërbimeve nga ana tjetër”*, parasheh neni 2 i LMK. Ndërsa, ligji e përkufizon konsumatorin si *“çdo person fizik i cili blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta, që nuk ka të bëjë me veprimtari tregtare, biznesor, zeytare apo profesionale”*.

Pra, në rastet e lartcekura kur kontrata lidhet në mes të një tregtari dhe konsumatori, me qëllim të mbrojtjes së këtij të fundit, kontraktuesit duhet të respektojnë kërkesat formale shtesë si në vijim: (i) tregtari duhet të ofroj informacione në mënyrë të përshtatshme për mjetet e komunikimit në distancë të përdorura në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme; (ii) nëse kontrata e obligon konsumatorin për pagesë, tregtari duhet ta vë në dijeni konsumatorin në mënyrë të qartë, të duhur dhe të drejtpërdrejt për këtë; (iii) tregtari duhet të siguroj që konsumatori, përgjatë porosisë së blerjes, shprehimisht njoftohet se porosia nënkupton obligimin për të paguar; (iv) ueb-faqet tregtare duhet të paraqesin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme jo më vonë se në fillim të procesit të porositjes nëse ekzistojnë kufizime mbi dërgesën dhe mënyrat e pagesave të cilat pranohen; dhe kërkesa tjera të parapara me nenin 41 të LMK.

## III. Kontratat të cilat nuk mund të nënshkruhen në mënyrë elektronike

Përbashimisht, disa kontrata nuk mund të nënshkruhen në mënyrë elektronike pasi që për vlefshmërinë e tyre kërkohet formë e veçantë e nënshkrimit. Forma me shkrim zëvendësohet edhe me deklarata me mjete elektronike, në qoftë se me ligj shprehimisht nuk caktohet ndryshe, parasheh paragrafi 5 i nenit 57 të LMD.

Kontratat të cilat duhet të nënshkruhen në mënyrë të veçantë janë kontratat të cilat duhet domosdo të vërtetohen tek noteri në mënyrë që të plotësohet validiteti formal i tyre. Përpunimi i detyrueshëm noterial vlen për kontratat me të cilat bëhet (i) bartja apo përvetësimi i pronësisë apo të drejtave të tjera reale mbi pronën e patundshme; (ii) themelimi i hipotekës në pronën e patundshme; (iii) kontratat e martesës dhe marrëveshjet lidhur me raportet pronësore në mes të bashkëshortëve apo personave që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore; dhe kontratat që kanë për qëllim (iv) themelimin e organeve të

përbashkëta dhe kompanive të biznesit si dhe themelimi dhe ndryshimi i statuteve të organeve dhe kompanive të tilla, parasheh neni 30 i Ligjit për Noterinë.

Në rastet tjera, palët kontraktuese, gjithashtu, “mund të merren vesh, që forma e veçantë të jetë kusht për vlefshmërinë e kontratës së tyre”, parasheh neni 54 i LMD. Në këto raste, “në qoftë se palët kontraktuese kanë parashikuar formën e caktuar vetëm për të siguruar provën për lidhjen e kontratës së tyre, ose për të arritur diçka tjetër, kontrata është e lidhur kur të jetë arritur pëlqimi për përmbajtjen e saj, ndërsa për kontraktuesin ka lindur në të njëjtën kohë detyrimi që kontratës t’i japin formën e parashikuar”.

#### IV. Përmbartimi i Kontratave të nënshkruara në mënyrë elektronike

Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës dhe pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit, parasheh neni 8 i LMD.

Megjithatë, ndodh që përgjatë marrëdhënieve kontraktuale njëra palë të mos i përmbush detyrimet e veta dhe për këtë arsye pala tjetër detyrohet t’i drejtohet organeve kompetente për zbatimin e dhunshëm të kontratës. Në rastet kur detyrimi i palës kontraktuese është në të holla atëherë, ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet me përmbartim.

Me këtë rast ngritët edhe çështja e vlefshmërisë së kontratës në mes të palëve përkatësisht, vërtetësia e saj. Pra, **a është kontrata e nënshkruar në mënyrë elektronike e përmbartueshme** apo jo?

Kontratat në përgjithësi nuk janë të përmbartueshme në mënyrë automatike. Organi përmbartues e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (*titulus executionis*) ose dokumentit të besueshëm, parasheh neni 21 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore (në tekstin më tutje “LPP”).

Në rastin konkret, duhet sqaruar se kontratat komerciale sipas LPP nuk janë as dokumente përmbartuese e as dokumente të besueshme. **Dokumente përmbartues** janë: (i) vendimet dhe ujdite gjyqësore; (ii) vendimet dhe marrëveshjet të arbitrazhit; (iii) dokumentet noteriale; (iv) kontratat për hipotekën të vërtetuara nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik dhe (v) dokumentet tjera që me ligj konsiderohen si dokumente përmbartuese, parasheh neni 22 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Ndërsa, **dokumente të besueshme** janë: (i) kambialet dhe çequet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; (ii) ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale; dhe (iii) faturat, parasheh neni 29 i LPP. Gjithashtu, ligji parasheh se “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”.

Nga të lartcekurat u konstatua se kontratat komerciale nuk janë të përmbartueshme por, **fatura është dokument i besueshëm** dhe kjo është e mjaftueshme për realizimin e borxhit ndaj palës tjetër. Nëse në mes të palëve kontraktuese është nënshkruar një kontratë komerciale në çfarëdo mënyre (me nënshkrim elektronik ose të shtypur) dhe kontrata ka për objekt realizimin e një shërbimi ose transaksion të mallit atëherë, domosdo pala tjetër do të lëshoj faturë për shërbimin e realizuar ose mallin e shitur. Fatura është dokument i besueshëm dhe i mjaftueshëm për të iniciuar procedurën përmbartimore.

Rekomandojmë që pala duhet të ketë parasysh disa formalitete procedurale të cilat duhet t’i përmbush në mënyrë që përmbartimi të jetë i plotë dhe i pranueshëm nga ana e përmbartuesit privat.

Së pari, në kontratë gjithmonë keni parasysh të përfshini një klauzolë e cila parasheh dorëzimin e faturës në mënyrë elektronike dhe adresat e postës elektronike zyrtare të kontraktuesve.

Së dyti, fatura duhet të tregojë në mënyrë të qartë kreditorin, debitorin, objektin e faturës, llojin, shumën e saktë për pagesë dhe kohën ose afatin për përmbushjen e detyrimit monetar.

Së treti, dorëzimi i faturës duhet të bëhet në mënyrë të rregullt ashtu që të mund të provoni se pala tjetër e ka pranuar.

Nëse kontraktuesi i ka plotësuar me përpikëri këto rekomandime atëherë mund të iniciojë procedurën përmbimore dhe të kërkojë përmbushjen e detyrimit monetar.

## Konkluzion

Kontratat komerciale në Kosovë mund të nënshkruhen në mënyrë elektronike dhe ligjërish ato janë të vlefshme. Përrjashtimisht, nuk mund të nënshkruhen në mënyrë elektronike kontratat të cilat duhet të kenë formë të veçantë sipas ligjit dhe këtu bëjnë pjesë kontratat që kanë objekt transaksionet lidhur me pronat e palaujtshme të cilat domosdo duhet të nënshkruhen pranë noterit dhe vërtetohen.

Kontratat me konsumatorë mund të nënshkruhen në distancë dhe në mënyrë elektronike por me kusht të plotësimit të disa kërkesave ligjore sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Kontratat komerciale të nënshkuara në mënyrë fizike ose elektronike, nuk janë dokumente të besueshme në kuptim të Ligjit për Procedurën Përmbimore andaj, nuk janë të përshtatshme për përmbim. Por, faturat për shërbimet e ofruara ose mallrat e shitura sipas kontratave komerciale janë dokumente të besueshme dhe si të tilla mund të përmbimohen nëse përmbajnë elementet e nevojshme sipas ligjit dhe nëse i dorëzohen palës debitorë në formë të rregullt.

Si përfundim, kontraktuesit palë në kontratat komerciale nuk do të duhej të hezitonin që kontratat t'i nënshkruajnë në mënyrë elektronike pasi që ligjërish, vullneti i palëve njihet edhe nëse shprehet në mënyrë elektronike.

**Avokat Vigan Rogova**